



Sërish sulmohet Policia në veri

KRONIKA | April 16, 2022 - 09:59

SHPËRNDAJE:  

Një veturë e policisë së Kosovës është sulmuar sërish në veri të Mitrovicës, kësaj radhe me mjete shpërthyes, të cilat dyshohet të jenë mjete piroteknike.

Sipas njoftimit të PK-së, sulmi ka ndodhur sot, më 16.04.2022, rreth orës 03:10, në Sharpej të Jarinjës, ku thuhet se kanë ndodhur dy shpërthime të cilat dyshohet nga mjete piroteknike, raporton Zeri.info.


“Shpërthimet kanë ndodhur afër veturës së policisë e cila ishte në një pikë statike ku policia ishte e përqendruar në parandalim të kontrabandës në atë zonë. Nga shikimi i vendit të ngjarjes është vërejtur se në xhamin e veturës policore ka mbetur një copë letre (dyshohet mbështjellës i mjeteve piroteknike).Ngjarja ka ndodhur në një pjesë që është afër territorit të Serbisë dhe dyshimi i bazuar është se këto mjete janë hedhur nga territori i Serbisë”, thuhet në njoftimin e PK-së.

Sipas njoftimit, thuhet se Policia ka qenë duke monitoruar një rrugë ilegale të mbyllur kohë më parë dhe e cila përdorej për kontrabandë të mallrave.

“Nga ky rast, nuk ka persona të lënduar as dëme materiale. Policia është duke e trajtuar rastin dhe do të vazhdojë aktivitete operative për të parandaluar aktet kriminale trans-kuftare në atë zonë dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë, thuhet në njoftimin e PK-së.


Kujtojmë se dje u raportua për disa sulme ndaj policisë së Kosovës në veri. Qeveria sulmet i quajti terroriste, ndërsa thanë se kanë informacione se sulmet erdhën nga pjesa e Serbisë. /Zëri

Të rekomanduara



Bie nga kati i tretë, vdes një punëtor në...

April 14, 2022



Prishtinasi kanoset nga ish-gruaja në rrjetet...

April 14, 2022

Arrestohet obiliqasi pasi plagosi një qen

KRONIKA | April 14, 2022

Gjobë dhe heqje e patentës ndaj dy shoferëve në Ferizaj për tejkallim të shpejtësisë

KRONIKA | April 14, 2022

Policia nis hetimet për tri vdekje të dyshimta në Prishtinë

KRONIKA | April 14, 2022

Prishtinasi vret veten, i la një mesazh gruas

KRONIKA | April 14, 2022

U alivanos në Zonën Industriale, vdes në QKUK një shtetas i huaj

KRONIKA | April 13, 2022

Arrestohet në Gjirokastër 24-vjeçari nga Kosova, u kap me 64 emigrantë në furgon

KRONIKA | April 12, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | April 14, 2022

Prishtinasi vret veten, i la një mesazh gruas



KRONIKA | April 15, 2022

Vdes në spital kosovari i goditur nga vetura në një autostradë në Zvicër




KRONIKA | April 15, 2022

Vritet një person në Zllakuqan, tre të arrestuar



KRONIKA | April 14, 2022

Policia nis hetimet për tri vdekje të dyshimta në Prishtinë



KRONIKA | April 14, 2022

Të shtëna me armë zjarri në veri të Mitrovicës, Policia jep detaje



KRONIKA | April 14, 2022

Bie nga kati i tretë, vdes një punëtor në Klinë